



Pranuar / Dërguar Punimja/Produkti Received/Deliver		05-05 2023		3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinita Org./Unit	Id Prot Id Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Koliciana Quantity		
SKIMSHK	4122/2023		114		



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A.nr. 759/2021

**Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin e dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi anëtare me Rushit Kajtazi- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, për shqyrtimin e ankesës A. Nr.759/2021, të datës 24.08.2021, së ankuesit**

sipas Aktgjykimit A. Nr.2459/21, të datës 23.03.2023, të Gjykatës Themelore në Prishtinë kundër organit të punësimit Agjencia Kosovare e Privatizimit, në çështjen juridike "ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nen paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 04.05.2023, mori këtë;

**V E N D I M**

**I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A. Nr.759/2021,të datës 24.08.2021,së ankuesit**

**II. MBETET në fuqi njoftimi me numër 8978 i datës 24.10.2019 i Agjencisë Kosovare të Privatizimit.**

**A r s y e t i m**

Ankuesi \_\_\_\_\_ me datë 10.10.2019, ka parashtruar kërkesën për lëshuarjen e aktvendimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, me arsyetimin se nga viti 2006, deri me muajin maj të vitit 2013, ka qenë i punësuar në pozitën „ Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa” në Agjencinë për Privatizim të Kosovës, dhe për shkaqe shëndetësore ka dhënë dorëheqje për mes e- mailit zyrtar, mirëpo asnjëherë nuk i është aprovuar dhe nuk i është lëshuar vendimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

Menaxherja e Burimeve Njerëzore e Agjencisë Kosovare të Privatizimit me datë 14.10.2019, ankuesit i është përgjigjur në kërkesën e datës 10.10.2019, të cilin e ka njoftuar se me datën 16.05.2013, (ankuesi) keni pranuar letër konfirmimin zyrtar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit lidhur me dohqjen e juaj nga AKP.

Ankuesi i pakënaqur me përgjigjen e datës 14.10.2019, nga Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore, me datë 21.10.2019 me numër protokollit 8884, ka parashtruar ankesë tek Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave tek Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Ankuesi me datë 15.11.2019 me numër protokollit 5386/2019, me ankesë i është drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për leshurajën e aktvendimit mbi ndërprerjen marrëdhënies së punës nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 12.12.2019, me numër protokollit 5773/2019, ankuesin ka njoftuar se nuk mund të shqyrtojë dhe vendose lidhur me anesën e ankuesit, për shkak se Këshilli nuk ka anëtar për të vendosur.

Ankuesi i pakënaqur me njoftim me numër protokollit 5773/2019, të datës 12.12.2019, me datë 10.01.2020, ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë gjegjësisht në Departamentin Administrativ.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 05.08.2021, ka nxjerr aktgjykim A. Nr. 46/2020, me të cilin ka aprovuar pjesërisht kërkesë padinë e paditësit duke anuluar njoftimin e datës 12.12.2019 të KPMSHCK-së, duke e detyruar Këshillin që brenda afatit tridhjetë (30) ditësh të vendose lidhur me ankesën e ankuesit të datës 15.11.2019.

Serish Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 22.09.2021, me numër protokollit 4737/2021 për mes njoftimin ka njoftuar ankuesin se nuk mund të shqyrtojë dhe vendose lidhur me anesën e ankuesit, për shkak se Këshilli nuk ka anëtar për të vendosur.

Ankuesi i pakënaqur me njoftim me numër protokollit 4737/2021, të datës 22.09.2021, ka bërë precizimin e padisë duke parashtruar padi konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 10.03.2023, A. Nr.2459/2021, ka nxjerr Aktgjykim me të cilin ka aprovuar pjesërisht kërkesë padinë e paditësit duke anuluar Vendimin A. Nr. 717/2019, e datës 22.09.2022 të Këshillit, duke e detyruar Këshillin që brenda afatit tridhjetë (30) ditësh të vendose lidhur me ankesën e ankuesit të datës 24.08.2021.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A. Nr. 717/2019 e parashtruar më datë 15.11.2019, me numër protokolli 5386/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shënimin Civil të Kosovës; Aktgjykimi A. Nr. 2429/2021, i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Njoftimi i datës 24.10.2019 i Këshillit, Njoftimi i datës 22.09.2021 i Këshillit; kërkesë e datës 18.03.2019; Vërtetim i datës 13.11.2015; e -maili i datës 25.03.2013; Formuari i dorëzimit të detyrës; Kërkesë për kthim në vendim e punës e datës 29.03.2016; kërkesë e datës 10.10.2019; kërkesë e datës 25.03.2019, për dorëheqje; Ankesa e datës 21.11.2019, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Akt Emërimi i datës 24.12.2012; Autorizimi i 19.09.2016; vërtetimi i datës 13.11.2015; Fleteleshim i datës 16.07.2014; përgjigje në kërkesë e datës 14.10.2019; Përgjigje në ankesë e datës 22.11.2019, me numër protokolli 5500/2019, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pa bazuar sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka analizuar Aktgjykimin e datës 10.03.2023, A Nr. 2459/2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë /Departamentit për Çështje Administrative me të cilin aktgjykim e ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit, duke e anuluar njoftimin me numër A. Nr. 759/2021, të datës 22.09.2021, duke e detyruar Këshillin që brenda afatit tridhjetë (30) ditësh të vendose lidhur me ankesën e ankuesit të datës 24.08.2021, prandaj kolegji pasi që ka analizuar të gjitha provat dhe faktet konstaton se ankesa e ankuesit është e pa bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, sepse ankesën e ka parashtruar të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencia Kosovare e Privatizimit, jashtë afatit ligjore për parashtrimin e ankesave të paraparë me dispozitat ligjore ne fuqi, sepse ankuesi ka dhënë dorëheqje në vitin 2013 që sipas provave të lëndës dorëheqja ka qenë vullnetare, ndërsa ankuesi në vitin 2019 pretendon realizmin e të drejtave të tij lidhur me atë se ka qenë i punësuar në Agjencinë për Privatizim të Kosovës.

Në bazë të pretendimeve ankimorë të ankuesit dhe provave relevante pas administrimit të tyre, lidhur me këtë çështje juridike. Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se ankuesi me datën 25.03.2013 për mes e- mailit ka parashtruar kërkesën për dorëheqjeje për shkaqe shëndetësorë, mirëpo asnjëherë nuk i është aprovuar dhe nuk i është lëshuar vendimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, ndërsa me datë 21.10.2019, me numër protokolli 8884, ka parashtruar ankesën tek Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave tek Agjencia Kosovare e Privatizimit, me arsyetimin për leshaurjen e aktvendimin për ndërprerjen marrëdhënies e punës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se ankuesi me datën 25.03.2013, për mes e- mailit ka parashtruar kërkesën për dorëheqjeje nga shërbimi civil për shkaqe shëndetësorë, ndërsa me datë 21.10.2019, me numër protokolli 8884, ka parashtruar ankesën tek Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave tek Agjencia Kosovare e Privatizimit, kundër përgjigjes së Udhëqesës së Burimeve Njerëzore e cila ankuesin ka njoftuar se ka pranuar letër konfirmimin e dorëheqjes në vitin 2013, ndërsa ankuesi nëse ka qenë i pa kënaqur me këtë përgjigje është dashur të bëjë ankesë konform dispozitave

ligjore në fuqi që rregullojnë shërbimin civil, ankuesi nuk e ka shfrytëzuar këtë të drejtë dhe i cili ka vepruar në kundërshtim me nenin 130.1 paragrafi a të Ligjit Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative ku është e përcaktuar *se Ankimi administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose për refuzimin për të nxjerrë aktin*, si dhe në pajtim me nenin 8 paragrafi 2 të Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave ku thuhet se *Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej (30) ditësh kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tije nga marrëdhënia e punës.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, ka konstatuar se Agjencia Kosovare e Privatizimit, lidhur me rastin e nxjerrjes së Njoftimi me numër 8978, të datës 24.10.2019, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, lidhur me ankesën e ankuesit

së në kohën e parashtrimit të ankesës nga ankuesit ka qenë në fuqi të Ligjit nr. 06/L- 114 për Zyrtarët Publikë dhe se nëpunësit civil kanë pasur të drejtë të parashtroje ankesë direkt në Këshill e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Theksuar si me sipër, Kolegji duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

*Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës*  
Lënda A. Nr.759/2021

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit;
- Drejtorit Menaxhues të Agjencionit Kosovar të Privatizimit;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
- Arkivit të KPMSHCK-së